

Ligjërata, 27.03.2015

PENGESAT MARTESORE

Pengesat martesore janë fakte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht në ligj, ekzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vlefshme.

Pengesat martesore në të drejtën tonë janë:

- **Mungesa e vullnetit**
- **Martesa ekzistuese**
- **Sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar**
- **Gjinia dhe**
- **Mituria**

Pengesat martesore klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme, si:

A. Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme. Të evitueshme janë ato pengesa martesore për të cilat gjykata mund të jep leje për lidhjen e martesës, në rastet e parashikuara me dispozita ligjore. Pengesat e tilla janë: mituria, gjinia e krushqisë.

Pengesat martesore të paevitueshme janë pengesat, për të cilat gjykata nuk mund të jep leje për lidhjen e martesës. Të tilla janë gjinia e gjakut mungesa e vullnetit sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar.

B. pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme.

Pengesat martesore të përhershme janë ato pengesa që deri në vdekje nuk pushojnë të ekzistuarit edhe me kalimin e kohës. P.sh gjinia e gjakut. Pengesat martesore të përkohshme janë pengesat të cilat me kalimin e kohës mund të pushojnë së ekzistuarit. P.sh. Mituria.

Pengesat martesore absolute dhe relative. Pengesat martesore absolute pamundësojnë lidhjen e martesës me cili do person të tilla janë mituria nën moshën 16 vjeçare, martesa ekzistuese. Këto pengesa veprojnë erga omnes ndërsa të drejtën për paraqitjen e padisë e kanë si bashkëshortët, prokurori i shtetit dhe çdo person tjetër që ka interes juridik.

Pengesat martesore relative pamundësojnë lidhjen e martesës vetëm ndërmjet personave të caktuar. P.sh gjinia e krushqisë pengesat e tilla veprojnë inter partes dhe të drejtën në padi për anulimin e martesës e kanë vetëm bashkëshortët.

Mungesat e vullnetit. Vullneti i deklaruar lirisht është prezumim e vetëm për lidhjen e martesës së vlefshme dhe e fiton rëndësinë e vet kur të jetë i shprehur dhe ët tjerët do të jenë në mundësi për ta kuptuar atë vullnet. Dhuna nënkupton shtrëngimin apo kanosjen e njërit bashkëshort apo dy bashkëshorteve për të lidhur martesë kundër vullnetit të tyre. Dhuna mund të jetë psikologjike dhe fizike. Dhuna është psikologjike kur ekziston kërcënim i ndaj bashkëshortit tjetër për të lidhur martesë

kundërshtim me vullnetin e tij, sepse në qoftë se nuk e deklaroi vullnetin për lidhjen e martesës do të shkaktohet ndonjë e keqe e madhe ose ndaj tij do të ushtohet dhunë fizike. Kanosja duhet të jetë serioze e mundshme dhe e kundërligjshme. Dhuna fizike dallon nga dhuna psikologjike sepse ajo fillon të ekzekutohet. P.sh. Mbatja e dorës me forcë me rastin e firmosjes së deklaratës së vullnetit për lidhjen e martesës.

Lajthimi ekziston kur njëri bashkëshort ka pasur mendim të gabueshme mbi rrethanat, faktet dhe mbi cilësitë thelbësore të bashkëshortit tjetër për lidhjen e martesës. Lajthimi mund të jetë:

A) Lajthimi për personin fizik kur njëri bashkëshort duke menduar se po lidhte martesën me personin a e lidh martesën me personin b.

b) Lajthimi për personin qytetar ekziston kur një person lidh martesë me një person tjetër fizik, me të cilin s'ka mundur dhe s'ka pasur qëllim që të martohet. Kjo ndodh kur personi qytetar i falsifikon dokumentet e identifikimit dhe atributet e personit si emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, vendbanimin si dhe shtetësinë.

C) Lajthimi për cilësitë thelbësore të personit ekziston nëse njëri prej bashkëshortëve është në lajthitje mbi cilësitë e personit tjetër me rastin e lidhjes së martesës p.sh. Sëmundja psikike paaftësia e përhershme për bashkim seksual etj.

Martesa ekzistuese ligji parasheh pavlefshmërinë e martesës së re derisa sa martesa e parë e njërit bashkëshort nuk zgjidhet ose nuk pushon në mënyrën e paraparë me ligj. Kjo do të thotë se nuk mund të lidhet një martesë tjetër para se të zgjidhet e mëparshmja.

Sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar. Nuk mund të lidh martesë personi me sëmundje psikike ose me zhvillim mendor të metë dhe personi me pazotësi veprimi. Sëmundja dhe pazotësia e veprimit duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës. Nëse paraqiten pas lidhjes së martesës ajo bëhet shkak për zgjidhjen të martesës. Arsyeja që kjo të jetë pengesë martesore qëndrojnë në faktin se personi pazotësi veprimi nuk mund të bënë deklarin e vullnetit në mënyrë valide dhe se sëmundja psikike mbartet nga prindërit në pasardhësit.

Gjinia e gjakut është pengesë martesore në shkallë dhe vija të parapara me dispozita ligjore. Kështu në vij të drejtë pakufi kurse në vij të tërthortë deri në shkallën e katërt. Gjinia e gjakut paraqitet si pengesë absolute martesore për shkak oportuniteti, si morali psikologjike dhe arsye eugjenike apo biologjike.

E drejta trashëgimore

Trashëgimia e domosdoshme

Çdo trashëgimtar ka të drejtë në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë ligjore, pjesë e domosdoshme e pasurisë trashëgimore është e rregulluar me dispozita ligjore inperative. Trashëgimtarëve, të cilëve është garantuar e drejta e trashëgimisë me ligj quhen trashëgimtarët e domosdoshëm, ndërsa pjesa e pasurisë në të cilin ata kanë të drejtë quhet pjesë e domosdoshme e pasurisë.

E drejta në testament ka qenë e kufizuar edhe në të drejtën Romake dhe edhe sot e kësaj dite me pjesën e domosdoshme e cila i takon çdo trashëgimtari. Me testament testatori nuk mund të ndryshoj rrahët e trashëgimisë ligjore e as vlerën e pjesës së domosdoshme të pasurisë trashëgimore, pjesa e domosdoshme e pasurisë trashëgimore është jodisponibile.

Ligji i trashëgimisë e përkufizon pjesën e domosdoshme të pasurisë trashëgimore si pjesë me të cilin trashëgimlënësi nuk mund ta disponoj. Kur një trashëgimtari i cenohet pjesa e domosdoshme ai ka të drejt me padi reduktimi të kërkoj kthimin e pjesës së domosdoshme të pasurisë trashëgimore.

Trashëgimtarët e domosdoshëm ndahen në dy grupe. Në grupin e par e përbëjnë pjesë pasardhësit e trashëgimlënësit, të birësuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij. Këta trashëgimtar që të trashëgojnë kërkohet të plotësohet vetëm kushti i përgjithshëm që të jenë trashëgimtar ligjor dhe të thirren në trashëgimi.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë gjyshërit e gjyshet e trashëgimlënësit, motrat e dhe vëllezërit e trashëgimlënësit që janë trashëgimtar të domosdoshëm vetëm nëse janë të paaftë plotësisht për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë.

Llogaritja e pjesës së domosdoshme. Pasardhësve dhe bashkëshorteve u takon $\frac{1}{2}$ e hises që do të trashëgonin dhe pjesë tjetër pjesë e domosdoshme e trashëgimisë. Ndërsa trashëgimtarëve të tjerë do tu takonte $\frac{1}{3}$. Sipas dispozitave të nenit 32 së pari bëhet invertanizimi dhe vlerësimi i gjitha të mirat materiale të trashëgimlënësit, borxhet që në momentin e vdekjes i kishin të tjerët trashëgimlënësit, ato që trashëgimlënësi u kishte të tjerëve, shpenzimet e invertanizimit dhe vlerësimi të pasurisë trashëgimore shpenzimet e varrosjes së trashëgimlënësit si dhe shpenzimet e ngritjes së lapidarit. Nga shuma e përgjithshme zbriten borxhet që trashëgimlënësi u kishte personave të tjerë dhe shpenzimet e varrimit lapidarit dhe borxhet që trashëgimlënësit i kishin personat e tjerë e që nuk mund të arkëtohen.